

VENDIM
Nr. 182, datë 23.11.2016

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMEVE PËR SHITJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE ME PAKICË TE KLIENTËT QË FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I
SHËRBIMIT UNIVERSAL**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, germa “b”; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, neneve 19, pika 1, germa “a” dhe 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e “draftmetodologjisë së Përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “draftmetodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal” (bashkëlidhur drafti).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti